

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020 -2021, për **60 (gjashtëdhjetë)** të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Personel (Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti Juridik), Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike), Logjistikë (Fakulteti Ekonomik), Xhenio (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Pilot (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera).

**Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 korrik 2020.**

### **1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:**

- të jetë shtetas shqiptar;
- të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale;
- të mos jetë në ndjekje penale;
- të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata;
- të ketë figurë të pastër morale;
- të mos ketë probleme me deportimin;
- të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin;
- të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale;
- në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (01 Gusht 2021). Përrjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (01 Gusht 2021);
- të kenë gjatësinë trupore mbi 170 për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat ;
- të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit;
- të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së;
- të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.
- të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike;
- të jenë në zotërim të diplomës së arsimit të lartë, (minimumi beachelor) brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jomë pak se 6 (gjashtë);
- të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi.
- Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet:
  1. të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”;
  2. të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

## 2. Procedurat e aplikimit

- 2.1. Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në Aneksin A.
- 2.2. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandimin për pjesmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

## 3. Dokumentet për regjistrim:

3.1 Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Në fazën e regjistrimit

- kërkesë me shkrim;
- formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksi A;
- fotokopje e kartës së identitetit;
- fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;
- fotografi për dokument (4x6), 2 copë;
- formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit;
- raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit.
- analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë.

b) Në përfundim të testimit :

Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda **5 ditëve** duhet të paraqesin dukumentacionin e mëposhtëm:

- deëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- vërtetim nga përmbarimi;
- raporti mjekësor i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

3.2 Qendra e Personel Rekrutimit të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3.3 Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit nga QPR-ja.

## 4. Datat e testimit:

**Testi i Gjuhës së Huaj (anlisht): 20.07.2020**

**Testi Fizik: 21.07.2020**

**Testi Intelektual: 22.07.2020**

**Testi Psikologjik: 22.07.2020**

## 5. Të dhënat tabelore të Testimit të Aftësive Fizike:

Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra	
Pompa	Pikët	Pompa	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	1000 m, minuta	Pikët	1000 m, minuta	Pikët
57		34		70		64		3'19''		3'34''	
58	100	33	100	71	100	65	100	3'20''	100	3'35''	100
57	99	32	98	70	99	64	99	3'21''	99	3'36''	99
56	98	31	96	69	98	63	98	3'22''	98	3'37''	98
55	97	30	94	68	97	62	97	3'23''	97	3'38''	97
54	96	29	92	67	96	61	96	3'24''	96	3'39''	96
53	95	28	90	66	95	60	95	3'25''	95	3'40''	95
52	94	27	88	65	94	59	94	3'26''	94	3'41''	94
51	93	26	86	64	93	58	93	3'27''	93	3'42''	93
50	92	25	84	63	92	57	92	3'28''	92	3'43''	92
49	91	24	82	62	91	56	91	3'29''	91	3'44''	91
48	90	23	80	61	90	55	90	3'30''	90	3'45''	90
47	89	22	78	60	89	54	89	3'31''	89	3'46''	89
46	88	21	76	59	88	53	88	3'32''	88	3'47''	88
45	87	20	74	58	87	52	87	3'33''	87	3'48''	87
44	86	19	72	57	86	51	86	3'34''	86	3'49''	86
43	85	18	70	56	85	50	85	3'35''	85	3'50''	85
42	84	17	68	55	84	49	84	3'36''	84	3'51''	84
41	83	16	66	54	83	48	83	3'37''	83	3'52''	83
40	82	15	64	53	82	47	82	3'38''	82	3'53''	82
39	81	14	62	52	81	46	81	3'39''	81	3'54''	81
38	80	13	60	51	80	45	80	3'40''	80	3'55''	80
37	79	12	59	50	79	44	79	3'41''	79	3'56''	79
36	78	11	58	49	78	43	78	3'42''	78	3'57''	78
35	77	10	57	48	77	42	77	3'43''	77	3'58''	77
34	76	9	56	47	76	41	76	3'44''	76	3'59''	76
33	75	8	55	46	75	40	75	3'45''	75	4'00''	75
32	74	7	54	45	74	39	74	3'46''	74	4'01''	74
31	73	6	53	44	73	38	73	3'47''	73	4'02''	73
30	72	5	52	43	72	37	72	3'48''	72	4'03''	72
29	71	4	51	42	71	36	71	3'49''	71	4'04''	71
28	70	3	50	41	70	35	70	3'50''	70	4'05''	70
27	69	2	49	40	69	34	69	3'51''	69	4'06''	69
26	68	1	48	39	68	33	68	3'52''	68	4'07''	68
25	67			38	67	32	67	3'53''	67	4'08''	67
24	66			37	66	31	66	3'54''	66	4'09''	66
23	65			36	65	30	65	3'55''	65	4'10''	65
22	64			35	64	29	64	3'56''	64	4'11''	64
21	63			34	63	28	63	3'57''	63	4'12''	63
20	62			33	62	27	62	3'58''	62	4'13''	62
19	61			32	61	26	61	3'59''	61	4'14''	61
18	60			31	60	25	60	4'00''	60	4'15''	60